



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 11262-2719  
Dt: 14.01.2026

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në pajtim me dispozitat të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 24/2015 Mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, në bazë të Hartës Zonale 2022-2030 të Komunës së Gjakovës, nenit 11 të Rregullores për Bonuset e Zonimit, si dhe nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vendosur lidhur me formimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave ndaj vendimeve të Komisionit për Bonuse të Zonimit, me datë 14.01.2026, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Formohet Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave ndaj vendimeve të Komisionit për Bonuse të Zonimit, në këtë përbërje:
  1. Florent Koci – Kryesues
  2. Demokrat Gjocaj – anëtar
  3. Elvane Qarkaxhija – anëtare
2. Komisioni i përshkruar si në pikën e parë të këtij vendimi, duhet të ndërmer veprime konform legjislacionit në fuqi për trajtimin e ankesave ndaj vendimeve të Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave për Bonuse të Zonimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

**Vendimi i'u dorëzohet:**

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Të gjithë anëtarëve të komisionit
- Arkivit.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

